

XII. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

NOCIONET KRYESORE:

Kushtetutshmëria; ligjshmëria; supremacioni i kushtetutës; Gjykata kushtetuese ; kontrolli abstrakt (i drejtëpërdrejt) i kushtetutshmërisë ; kontrolli konkret (indirekt, i tërthortë) i kushtetutshmërisë ; kontrolli paraprak i kushtetutshmërisë ; kontrolli aksesori (represiv) i kushtetutshmërisë; kontrolli normativ; konflikti i kompetencës; konflikti pozitiv i kompetencës; konflikti negativ i kompetencës; anulimi i aktit juridik; ndërprerja e aktit juridik.

PYETJE:

- 1. Si është pozita e Gjykatës kushtetuese të RM-së në raport me sistemin gjyqësor?**
- 2. Kush i zgjedh anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të RM-së?**
- 3. Kush i propozon anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të RM-së?**
- 4. Sa zgjat mandati i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese të RM-së?**
- 5. Në çka konsiston kontrolli normativ që është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të RM-së?**
- 6. Cilat liri dhe të drejta i mbron Gjykata Kushtetuese e RM-së?**
- 7. Çka është konflikti i kompetencës?**
- 8. Çfarë lloje të konfliktit të kompetencës ekzistojnë?**
- 9. Ndërmjet cilëve organe Gjykata kushtetuese RM-së e zgjidh konfliktin e kompetencës?**
- 10. Çfarë roli ka Gjykata Kushtetuese e RM-së në procedurën e konstatimit të përgjegjësisë së kryetarit të shtetit?**
- 11. Në cilat raste ndërpritet mandati i gjykatësit të Gjykatës Kushtetuese të RM-së?**
- 12. Çka do të thotë që një akt juridik të ndërpritet?**
- 13. Çka do të thotë anulimi i aktit juridik?**
- 14. Kush i ekzekuton vendimet e Gjykatës Kushtetuese të RM-së?**
- 15. Çfarë aktesh sjell Gjykata Kushtetuese e RM-së?**

1.Format e mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë

Gjykata Kushtetuese e RM-së është organ që e mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria paraqesin parime themelore mbi të cilat duhet të ndërtohet sistemi juridik dhe politik në një shtet. Ato paraqesin një gjendje ku ka kushte, principe dhe rregulla dhe ligjet që i permban kushtetuta të respektohen dhe zbatohen në praktikë.

Permbajtja juridike e kushtetutshmërisë nënkupton harmonizimin e sistemit juridik dhe hierarkisë së akteve juridike në një shtet, në majë të të cilit gjendet Kushtetuta. Në thelbin e saj, kushtetutshmëria permba principin e supremacionit të Kushtetutës, që nënkupton se Kushtetuta është akt më i lartë juridik në shtet dhe të gjitha aktet e tjera duhet të jenë në pajtim me të.

Përmbajtja politike e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë nënkupton se aktiviteti i organeve të pushtetit shtetëror të jetë në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të shtetit. Në këtë mënyrë kushtetutshmëria dhe ligjshmëria janë principe të rëndësishme për frenimin e arbitraritetit të pushtetit shtetëror nëpërmjet futjes së tij nën normat juridike të veçanta.

Qëllimi i mbrojtjes së ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë është që të sigurojë respektimin e së drejtës në një shtet dhe jo vetëm nga ana e qytetarëve , por edhe nga udhëheqësit e pushtetit shtetëror , dhe në veçanti nga ana udhëheqësve të pushtetit legjislativ dhe pushtetit ekzekutiv. Ajo nënkupton se parlamenti në një shtet nuk ka liri të plotë në krijimin e së drejtës, por gjatë sjelljes së ligjeve dhe akteve të tjera duhet të mbajë llogari që ato të jenë në harmoni me dispozitat dhe principet e aktit më të lartë të shtetit – kushtetutës. E njëjta vlen edhe për pushtetin ekzekutiv gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve dhe gjatë sjelljes së akteve nënligjore që janë në kompetencë të saj.

Sot në teori ekziston konsensus në lidhje me nevojën e ekzistimit të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë . Por , format në të cilat kjo mbrojtje paraqitet janë të ndryshme. Në varësi të asaj se cili organ e kryen kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në një shtet, ekzistojnë shumë sisteme:

1. Sistemi i vetëkontrollit të ligjvënësisë. Ky sistem, mbështetet në teorinë e supremacionit parlamentar dhe në të organi legjislativ, vetë vlerëson se a janë ligjet në pajtim me kushtetutën. Në këtë sistem çështjen e kushtetutshmërisë së ndonjë ligji e parashatrojnë deputetët si pyetje paraprake gjatë debatit rreth ndonjë propozimligji. Ky sistem ekzistonte në sistemet e unitetit të pushtetit në vendet socialiste ku kuvendi formalisht ishte organ më i lartë i pushtetit.

2. Sistemi i kontrollit të kushtetutshmërisë nga ana e organit të posaçëm politik. Në shtetet që kanë pranuar këtë sistem, kontrolli i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është në kompetencën e një organi politik, i cili më shumë ose më pak është i ndarë nga organi legjislativ. Lloji i organit që e ushtron kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është i ndryshëm, për shembull. Këshilli i së drejtës kushtetuese (në Hungari në vitin 1983), Presidiumi i këshillit të lartë (Bashkimi Sovjetik në vitin 1974) etj. Diskutabile është pyetja se a duhet Këshilli Kushtetues në Francë të klasifikohet në këtë grup të shteteve apo në grupin e

shteteve ku mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është në kompetencën e Gjykatës kushtetuese. Këshilli Kushtetues në Francë është një organ i përbërë nga 3 anëtarë të emëruar nga presidenti i Republikës, 3 anëtarë të emëruar nga kryetari i Kuvendit Kombëtar, 3 anëtarë të emëruar nga kryetari i Senatit, si dhe nga ish-kyetarët e Republikës të cilët janë anëtarë të tij.

3. *Sistemi i kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë nga Gjykatat e rregullta.* Ky sistem ekziston në SHBA, Kanada, Australi, Argjentinë, Brazil, Zelandë e Re dhe në shtete të tjera, ku mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë bëhet gjatë zgjidhjes së ndonjë kontesti konkret nga gjykatat e rregullta. Dallimi ndërmjet tyre është se a e ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të gjitha gjykatat ose vetëm Gjykata e lartë. Ky sistem i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është sistem i kontrollit konkret (indirekt, i tërthortë) i kushtetutshmërisë. Në të, çështja e kushtetutshmërisë paraqitet tërthorazi, si çështje sporadike. Çështja kryesore është kontesti konkret i paraqitur para Gjykatës. Për shembull, në SHBA gjatë zgjidhjes së ndonjë kontesti konkret mund të parashtrahet pyetja se, a është ligji në bazë të të cilit duhet të zgjidhet kontesti në pajtim me kushtetutën. Në qoftë se Gjykata vlerëson se ai ligj është në kundërshtim me kushtetutën, ajo nuk e anulon ligjin formalisht, por nuk e zbaton në rastin konkret. Mangësia kryesore e këtij sistemi është se përkundër asaj që gjykata ka vlerësuar se një ligj është kundërkushtetues, nuk e anulon atë, por ai ligj vazhdon të jetë në fuqi, që do të thotë se ndonjë gjykatë tjetër të njëjtin ligj mund ta trajtojë si të kushtetutshëm dhe ta zbatojë atë gjatë vendimmarrjes. Kjo sjell në pasiguri juridike duke e vënë në dyshim parimin e barazisë ligjore të qytetarëve para ligjit dhe organeve gjyqësore në shtet.

4. *Sistem i kontrollit të kushtetutshmërisë nga Gjykatat kushtetuese.* Në vendet që kanë pranuar këtë sistem të kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë formohet organ i posaçëm – gjykate kushtetuese, në kompetencë të së cilës është mbrojtja e kushtetutës përmes kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve në një vend. Ajo ushtron kontroll *abstrakt* (të drejtepërdrejt) të kushtetutshmërisë, që nënkupton se çështja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ndonjë akti të caktuar është kontesti kryesor, përkatësisht ajo nuk del nga ndonjë kontest konkret. Në të drejtën e karahasuar kushtetuese ky sistem i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, i cili për herë të parë është zbatuar në Austri me Kushtetutën e vitit 1920, është më i përfaqësuar. Por në zbatimin konkret të tij ekzistojnë modifikime të ndryshme.

Varësisht nga koha se kur ushtrohet kontrolli i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, mbrojtja kushtetuese – gjyqësore mund të jetë papaprake (preventive) dhe akcesore (represive).

Kontrolli paraprak (preventive) i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë ushtrohet para hyrjes në fuqi të aktit pajtueshmëria e të cilit vlerësohet nëse është në pajtim me kushtetutën dhe ligjet. Ky kontroll paraprak mund të bëhet në disa mënyra, për shembull, në disa shtete kushtetutshmëria e ligjeve mund të kontestohet në periudhën ndërmjet sjelljes së ligjeve dhe kohës kur hyjnë në fuqi ato. Në shtetet e tjera, nga gjykata kushtetuese mund të kërkohet mendim për kushtetutshmërinë e ligjit gjatë procedurës së sjelljes së tij. Shembulli i tretë

është vlerësimi i kushtetutshmërisë së ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare, para se kjo të ratifikohet.

Kontrolli (represiv) akcesor kryhet pas sjelljes së ligjit dhe pas hyrjes në fuqi të tij. Ky lloj i mbrojtjes gjyqësore - kushtetues i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë është më i përdorur. I njëjti është prezent edhe në sistemin kushtetues të RM-së.

2. Pozita, përbërja dhe zgjedhja e Gjykatës Kushtetuese të RM-së.

Gjykata kushtetuese e RM-së është organ i veçantë dhe i pavarur në sistemin kushtetues të vendit. Është organ që gjendet jashtë kuadrit të gjyqësisë së rregullt.

Përbëhet nga nëntë gjyqtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i RM-së. Sipas Amendamentit XV të Kushtetutës të RM-së, Kuvendi zgjedh gjashtë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të RM-së me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve (shumicë absolute). Kuvendi i zgjedh tre gjyqtarë me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës duhet të ketë shumicë nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në RM.

Gjatë procedurës të propozimit të gjyqtarëve të Gjykatës kushtetuese janë të kyçura më tepër organe dhe atë: 2 gjyqtarë i propozon kryetari i RM-së, 2 gjyqtarë i propozon Këshilli gjyqësor Republikan dhe 5 gjyqtarë i propozon vetë Kuvendi, – komisioni për zgjidhje dhe emërimë. Gjyqtarët zgjidhen nga radhët e juristëve eminentë. Mandati i tyre zgjat 9 vjet, pa rizgjedhje.

Gjyqtarit të Gjykatës kushtetuese i pushon detyra nëse:

- paraqet dorëheqje;
- dënohet për vepër penale me dënim të burgimit pa kusht më së paku 6 muaj;
- përgjithmonë e humb aftësinë për ushtrimin e funksionit, që konstatohet nga Gjykata kushtetuese.

Gjykata kushtetuese zgjedh kryetarin e gjykatës nga radhët e saj me mandat prej 3 vitesh, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Funksioni gjyqtar i Gjykatës kushtetuese është i papajtueshëm me ushtrimin e ndonjë funksioni a profesioni publik ose me anëtarësimin në ndonjë parti politike.

Gjyqtarët e Gjykatës kushtetuese gëzojnë imunitet. Për imunitetin e tyre vendos Gjykata kushtetuese.

Gjyqtarët e Gjykatës kushtetuese nuk i nënshtrohen obligimit në forcat e armatosura.

3. Kompetenca e Gjykatës kushtetuese

Gjykata kushtetuese në RM në kompetencën e saj ka të drejta dhe detyrime.

3.1. Kontrolli normativ - kontrolli i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë

Kjo është kompetenca themelore e të gjitha Gjykatave kushtetuese dhe e Gjykatës kushtetuese të RM-së. Objekt i kontrollit janë *ligjet, normat e tjera dhe marrëveshjet kolektive*. Sipas Kushtetutës së RM-së, Gjykata kushtetuese e RM-së vendos për pajtueshmërinë :

- e ligjeve me Kushtetutën ;
- dhe normave të tjera dhe marrëveshjeve kolektive me Kushtetutën dhe ligjet.

Qëllimi i kësaj kompetence të Gjykatës kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmëri të rrendit juridik në RM, përkatësisht të sigurohet respektimi i parimeve kushtetuese gjatë sjelljes së akteve të tjera më të ulta. Procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ndonjë norme tjetër ose ndonjë akti tjetër të përgjithshëm ngrihet me vendim të Gjykatës kushtetuese me shkas të iniciativës së paraqitur. Çdo kush mund të paraqesë iniciativë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Edhe vetë Gjykata kushtetuese mund të ngrejë procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të ndonjë akti të caktuar juridik. Procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të ndonjë akti përfshin disa faza. Pas pranimit të iniciativës për ngritjen e procedurës, fillon procedura paraprake në të cilën kryhen veprime përgatitore, caktohet gjyqtari që do ta udhëheqë procedurën paraprake në të cilën ai e vlerëson iniciativën për ngritjen e procedurës, gjatë të cilës mund t'i thërret të gjithë pjesëmarrësit në procedurë dhe persona të tjerë të interesuar në bisedë konsultative dhe nga ato të kërkojë sqarime. Pas përfundimit të procedurës paraprake, gjyqtari është i detyruar të përgatisë referat që përmban të dhëna për kohën kur është paraqitur iniciativa, çfarë kërkesë është paraqitur, cilat përgatitje janë kryer, cilat konteste juridike dhe çështje faktike janë paraqitur gjatë punës me lëndën, përshkrimi i praktikës gjyqësore - kushtetuese me mendim dhe propozim për mënyrën e zgjidhjes së kërkesës së parashtruar.

Referatet shqyrtohen në seancën e Gjykatës kushtetuese. Vendimet sillen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të Gjykatës kushtetuese, vetëm nëse me Kushtetutë dhe Rregulloren e Gjykatës kushtetuese nuk është e rregulluar ndryshe. Gjyqtari që ka votuar kundër vendimit të sjellë mund ta veçoj mendimin e tij dhe ta arsyetojë me shkrim. Kjo publikohet në “ Buletinin e Gjykatës ”.

Për qartësimin e gjendjes faktike dhe juridike për lëndë të caktuara, Gjykata kushtetuese mund, në çdo fazë të procedurës, të vendosë të mbajë seancë përgatitore. Në seancën përgatitore thirren pjesëmarrësit në procedurë, organe dhe organizata profesionale, punëtorë shkencorë dhe profesionistë që do t'i caktojë Gjykata. Në shqyrtimin e seancës përgatitore mund të parashtrihen

pyetje, te shprehen mendime dhe komente në lidhje me çështjet dhe rrethanat kontestuese të rëndësishme për marrjen e vendimit.

Gjykata mund të vendosë që shqyrtimi gjyqsor të jetë i hapur, ku përpos pjesëmarrësve në procedurë thirren edhe organe dhe organizata të caktuara, punëtorë shkencorë dhe profesionistë, dhe informohen edhe mjetet e informimit publik.

Kur pas mbajtjes së shqyrtimit publik, përkatësisht pas seancës së mbajtur, Gjykata kushtetuese do të konstatojë se lënda është e sqaruar mirë, kalohet në këshillim dhe votim, i cili kryhet pa prezencën e publikut.

3.2. Mbrojtja e lirive dhe e të drejtave të caktuara

Për dallim nga Gjykatat kushtetuese në botë të cilat i mbrojnë të gjitha të drejtat kushtetuese, Gjykata kushtetuese e RM-së mbron vetëm disa liri dhe të drejta, si :

- e drejta e bindjes, mendimit dhe shprehjes së lirë të mendimit;
- veprimtaria dhe bashkimi politik;
- ndalimi i diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racë, religjionit, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike.

Çdo qytetar që mendon se ndonjë nga këto të drejta i janë cënuar me ndonjë akt individual ose veprim, mund të kërkojë mbrojtje nga Gjykata kushtetuese në një afat prej 2 muajsh nga dita e dorëzimit të aktit përfundimtar ose të aktit individual të formës së prerë, përkatësisht nga dita e njoftimit për ndërmarrjen e veprimit me anë të të cilit është bërë cënimi, por jo më shumë se 5 vjet nga dita e marrjes së tij.

Në kërkesën e tij, qytetari duhet t'i theksojë shkaqet në bazë të të cilave kërkon mbrojtje, aktet ose veprimet me të cilat ato janë cënuar, faktet dhe provat ku bazohet kërkesa etj. Kjo kërkesë i dërgohet për përgjigje organit që ka sjellë aktin individual, përkatësisht organit që ka ndërmarrë veprimin me të cilin ato të drejta janë cënuar në afat prej 3 ditësh nga dita e paraqitjes. Pastaj caktohet shqyrtimi publik në të cilën thirren palët pjesëmarrëse në procedurë dhe avokati popullor, dhe sipas nevojës edhe persona të tjerë, organe dhe organizata. Gjatë procedurës, Gjykata kushtetuese mund të sjellë vendim për pezullimin e ekzekutimit të aktit individual ose veprimit deri në sjelljen e vendimit përfundimtar.

3.3. Zgjidhja e konfliktit të kompetencave

Gjykatat kushtetuese në shumë shtete janë edhe gjykata të cilat zgjidhin konteste mbi kompetencën. Konflikti i kompetencës është një situat kur dy ose më shumë organe deklarojnë se ndërmarrja e një aktiviteti të caktuar është në kompetencën e tyre – ky është *konflikt pozitiv i kompetencës*. Konflikti i kompetencës ekziston edhe atëherë kur dy ose më shumë organe deklarojnë se ndërmarrja e një aktiviteti të caktuar nuk është në kompetencën e tyre – ky

është *konflikt negativ i kompetencës*. Gjykata kushtetuese në RM vendos mbi konfliktin e kompetencave:

- bartësve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe pushtetit gjyqësor;
- organeve të Republikës dhe njësive të vetëqeverisjes lokale.

Propozim për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës mund të paraqesë secili nga organet ndërmjet të cilëve ka ndodhur konflikti dhe secili organ që për shkak të pranimit ose refuzimit të kompetencës së disa organeve nuk mund ta realizojë të drejtën e tij. Propozimi mund të paraqitet nga ana e organeve që gjenden në kontest që kur njëri nga organet me akt përfundimtar ose të formës së prerë e pranon ose e refuzon kompetencën. Personi i cili nuk mund ta realizojë të drejtën mund të paraqesë propozim që kur të dy organet do të sjellin aktin përfundimtar ose të formës së prerë për pranimin ose refuzimin e kompetencës. Në këto konteste, Gjykata kushtetuese me vendim e përcakton organin kompetent për vendosjen mbi lëndën.

3.4. Vendimmarrja mbi përgjegjësinë e presidentit të RM-së

Gjykata kushtetuese e RM-së vendos mbi përgjegjësinë e presidentit të RM-së. Procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së presidentit të RM-së e ngre Kuvendi i RM-së me 2/3 e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Propozimi, që përmban përshkrimin dhe faktet për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjit që i ngarkohet presidentit të RM-së, i paraqitet Gjykatës kushtetuese të RM-së. Gjykata kushtetuese kërkon mendim nga presidenti i Republikës për pretendimet nga propozimi i Kuvendit. Vendimin për përgjegjësinë e presidentit të RM-së për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjeve në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij. Gjykata kushtetuese e sjell me 2/3 e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i gjyqtarëve. Gjykata kushtetuese në rrugë zyrtare *e konstaton debutimin e kushteve për ndërprerjen e funksionit president i Republikës* përshkak të vdekjes, dorëheqjes, pamundësisë së përhershme të ushtrimit të funksionit ose ndërprerjen e mandatit me forcën e Kushtetutës. Kjo bëhet mbi bazën e akteve, konstatimeve, mendimeve të ekspertëve të medicinës ose institucioneve të tjera, në pajtim me ligjin.

3.5. Vendimmarrja mbi kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave të qytetarëve

Gjykata kushtetuese e RM-së vendos edhe për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave të qytetarëve. Kushtetuta e RM-së garanton lirinë e shoqatave të qytetarëve për arsye të realizimit të të drejtave politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe bindjeve të tjera të tyre. Por, programet dhe aktivitetet e shoqatave të qytetarëve dhe të partive politike nuk mund të drejtohen nga prishja e rendit kushtetues të Republikës dhe nga nxitja ose thirrja për agresion ushtarak ose ngjalljen e urrejtjes nacionale, racore, fetare dhe jotolerancës. Kushtetuta e RM-së ndalon edhe shoqatat ushtarake ose gjysmëushtarake që nuk u përkasin forcave të armatosura të RM-së. Në kompetencën e gjykatës kushtetuese bie edhe e drejta, në qoftë se konstaton se programet dhe statutet e partive politike dhe të shoqatave të qytetarëve janë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, t'i anulojë ose t'i ndërprejë ato.

4. Karakteri dhe efekti juridik i vendimeve të Gjykatës kushtetuese

Gjykata kushtetuese sjell vendime, aktvendime dhe përfundime.

Gjykata kushtetuese sjell *vendime kur vendos për esencën e punës*: për anulimin ose shpalljen e pavlefshme të ndonjë akti, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave që janë vendosur në kompetencën e saj, për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës, për konstatimin e përgjegjësisë së kryetarit të shtetit etj.

Gjykata kushtetuese sjell *aktvendim*: për ngritjen e procedurës, për ndërprerjen e procedurës, për hedhjen poshtë të iniciativave, propozimeve dhe kërkesës, për ndërprerjen e ekzekutimit të akteve të caktuara etj.

Gjykata kushtetuese sjellë *përfundime*: për aktivitetet që ndërmeren gjatë procedurës.

Vendimet e Gjykatës kushtetuese u dërgohen pjesëmarrësve në procedurë dhe shpallen në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Gjatë vendosjes për kushtetutshmërinë e ligjit ose për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e ndonjë norme ose akti të përgjithshëm, kontratës kolektive, statutit ose programit, gjykata kushtetuese të njëjtat mund t'i *ndërpresë* ose t'i *anulojë*. Vendimi për ndërprerjen e një akti të caktuar do të thotë që ai nuk është më në fuqi dhe nuk zbatohet nga momenti i shpalljes së vendimit të Gjykatës kushtetuese në “Gazetën zyrtare të RM-së”. Vendimi për anulimin e një akti të caktuar ka për qëllim t'i mënjanojë edhe pasojat juridike që kanë ngjarë nga akti i shpallur si i anuluar, përkatësisht të prodhojë efekt sikur ky akt asnjëherë nuk ka ekzistuar.

Vendimet e Gjykatës kushtetuese janë përfundimtare dhe ekzekutive.

Vendimet e Gjykatës kushtetuese i zbaton sjellësi i ligjit, normës tjetër ose aktit të përgjithshëm që me vendim të Gjykatës është anuluar ose shpallur i pavlefshëm.

Vendimet me të cilat Gjykata vendos për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë i ekzekuton organi ose organizata që ka sjellë aktin individual që me vendim të Gjykatës është shpallur i pavlefshëm, përkatësisht organi ose organizata që ka ndërmarrë aktivitetin të cilin Gjykata kushtetuese me vendim e ka ndaluar.